



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1902/14 Prot.

Tiranë, më 31.12 2014

VENDIM

“Mbi pranimin e ankesës”

Nr. 02, datë 31/12/ 2014

Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të nenit 31/1/a/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nenit 16 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës të Qendrës “Res Publica”, nr.1902 Prot., datë 11.12.2014, kundër autoritetit publik/Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me objekt “Refuzimin e dhënies së dokumenteve zyrtare”;

V Ë R E N:

Nga shqyrtimi i ankesës së depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, nga Qendra “Res Publica”, rezulton se ajo është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Sipas kërkesës nr. 281/14 Prot., datë 12.11.2014, drejtuar autoritetit publik(AP)/ Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ankuesi ka kërkuar kopje të vendimeve nr.9, 10, 16, 30, 31, 32, 43, 52, 70,71, 72, 73, 81, 82, 83, 84, 90, 91, 93, 94, 98, 103, 107, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 123, 124, 125, 126 të vitit 2014, si dhe çdo vendim tjetër të marrë nga KLD pas vendimit nr. 135/2014, nëse ka të tillë të cilat nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Vendimet e cituara nga ankuesi Qendra “Res Publica”, përfshihen në kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, megjithatë në përputhje me nenin 16 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” autoriteti publik duhet të japë një përgjigje për kërkuuesin. Gjithashtu, duke qenë se kërkesa për informim nuk e ka përcaktuar qartë formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai duhet të jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

Në tejkallim të afatit të parashikuar në nenin 15/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nuk rezulton që ankuesi Qendra “Res Publica” të jetë pajisur me informacion. Ky veprim rezulton të jetë kryer në kundërshtim me nenin 15/4 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin shprehimisht thuhet se “...Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve do të konsiderohet refuzim”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri bazuar në nenin 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ka kërkuar autoritetit publik që deri në datë 24.12.2014 të depozitojnë parashtrimet me shkrim mbi ankesën e paraqitur nga Qendra “Res Publica” dhe njëkohësisht ka orientuar atë të pajisë me përgjigjen përkatëse kërkuuesin, aktualisht në cilësinë e ankuesit pranë KDIMDP-së. Nga shqyrtimi i parashtrimeve të dërguara datë 24.12.2014, rezultoi të jenë dhënë shpjegime mbi arsye teknike të mos përditësimit të faqes zyrtare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe se, vendimet e pa publikuara janë të një natyre rutinore që sipas gjykimit të tyre nuk kanë pasur interes për publikun. Gjithashtu, në parashtrime shpjegohet se pas këtij konstatimi është vepruar menjëherë me vendosjen e tyre në faqen e internetit.

Zyra e Komisionerit pasi verifikoi faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë konstatoi se përditësimi i saj me vendimet përkatëse nuk ishte i plotë. Për këtë shkak me anë të urdhrin nr.242, datë 29.12.2014 të Komisionerit, nisi inspektimin administrativ pranë këtij autoriteti publik me objekt “*Verifikim mbi ankesën e depozituar pranë Zyrës së Komisionerit nr.1902 Prot., datë 11.12.2014 nga Qendra “Res Publica”, mbi refuzimin e dhënies së dokumenteve zyrtare nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.*”

Në përfundim, grupi i inspektimit mbajti proces-verbalin përkatës në datë 30.12.2014, në të cilin u pasqyruan konstatimet e inspektimit administrativ. Nga verifikimi online dhe në prani të përfaqësuesve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë u provua mungesa e publikimit të disa vendimeve, më konkretisht vendimet nr.30, 43, 70,71, 83, 84, 90, 91, 93, 94, 98, 103, 107, 108, 115, 123,124, 125, të cituara në ankesën e Qendrës “Res Publica”. Përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë pretendoi se, faqja zyrtare është në përpunim dhe ka pasur problematika në publikimin e tyre.

Cënimi i të drejtës për informim është një ndër të drejtat themelore më të rëndësishme për individin dhe shoqërinë në tërësi e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe garantimi i kësaj të drejte të shkelur siç është edhe rasti në fjalë, monitorohet dhe ndëshkohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në aplikim të nenit 18/2/a të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, refuzimi i dhënies së informacionit është kundërvajtje administrative dhe si i tillë ky mosveprim nga ana e autoritetit, dënohet me gjobë nga 150.000 deri në 300.000 lekë. *Sanksioni administrativ në këtë rast i atribuohet koordinatorit për të drejtën e informimit, në përputhje me nenin 19/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.*

Në kushtet kur implementimi i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkon hartimin e projekt/programeve të transparencës nga autoritetet publike, brenda 6(gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e tij/nëntor 2014, Komisioneri vlerëson ndërmarrjen e masave më të shpejta dhe urdhërimin e zbatimit të detyrimeve ligjore ndaj individëve duke u rezervuar në ndëshkueshmëritë me gjobë vetëm në rastet e mos zbatimit të vendimit.

Në përfundim, nga shqyrtimi i parashtrimeve të autoritetit publik, nga gjetjet e konstatuara pas inspektimit të kryer, më konkretisht për mos përditësimin e faqes zyrtare me vendimet e marra nga KLD, për mos dhënie të informacionit ankuesit Qendrës “Res Publica”, në përputhje me objektin e ankesës si dhe nga shqyrtimi në tërësi i provave dhe bazueshmërisë ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankesa e Qendrës “Res Publica”, është e bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 7, 11/5, 24/3/4, 24/5/b/ç të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenit 16 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar;

V E N D O S A

1. Pranimin e ankesës nr. 1902 Prot., datë 11.12.2014 të Qendrës “Res Publica”.
2. Urdhërimin e autoritetit publik/Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të vënë në dispozicion vendimet e dhëna nga KLD sipas përcaktimeve të bëra në ankesë nga ankuesi Qendra “Res Publica”, në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik/KLD.
3. Publikimin/përditësimin në faqen zyrtare të vendimeve të dhëna nga KLD sipas përcaktimeve të bëra në proces-verbalin e datës 30.12.2014, deri në datë 09.01.2015.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Vendimi i njoftohet menjëherë palëve.

Ky vendim u dha sot në datë 31.12.2014.

KOMISIONERI

BESNIK DERVISHI

